

KONTRATËSHITBLERJE KUOTE

Sot, më datë 10/12/2023 (dymijë e njëzet e tre), Shitësi dhe Blerësi, ranë dakord për hartimin e kësaj Kontrate Shit – Blerje Kuote me termat e mëposhtme:

SHITËSI:

Z. Nikos Semanjakos, shtetas shqiptar, lindur më 09.04.1976 në Zharez, banues në Sheqishte, Zharrez, Fier madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar mbajtëse e pasaportës nr. H60409024B, (në vijim referuar si “Ortaku”)

DHËNËS PËLQIMI:

Znj. Sonila Semanjakos, shtetase shqiptare, lindur më 27.09.1979 në Fier, Shqipëri, banuese në Sheqishte, Zharrez, Fier madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtëse e pasaportës me numër H95927016N.


BLERËSI:

Z. Ulis Gjata, shtetas shqiptar, lindur në Fier më 03.05.1982 dhe me banim në Fier, Lagjia Bishanak, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. I20503022B. (në vijim referuar si “Blerësi”)

(Bashkërisht referuar si “Palët”).

DEKLARIME PARAPRAKE

1. Shoqërisë tregtare 3 AD Energy Sh.p.k., shoqëri e së drejtës shqiptare, e regjistruar në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me numër identifikimi NIPT L61613007U, me seli në TIRANE Farkë, Rruga e Kopshtit Botanik, Pallati Rinia 04, Kati 0 përfaqësuar nga Administratori Znj. Anilda Goga.aj (më tej referuar si “Shoqëria”). Kjo shoqëri përbëhet nga dy ortakë të cilët janë pjesëmarrës në kapitalin e kësaj shoqërie në raportin:
 - a. Arben Goga, zotërues i një kuote të barabartë me 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë “3AD Energy” SHPK;
 - b. Nikos Semanjakos, zotërues i një kuote të barabartë me 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë “3 AD Energy” SHPK.
2. Kapitali aktual i Shoqërisë është në vlerën prej ALL 100.000,00 (një qind mijë lekë);



3. Shitësi kërkon të shesë plotësisht kuotën e tij tek Blerësi në përputhje me kushtet e kësaj kontrate duke patur miratimin paraprak të dhënë nga ortaku tjetër z. Arben Goga dhe Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve sipas Vendimit datë [__/__/2023] që i bashkëlidhet kësaj kontrate;
4. Blerësi është i interesuar të blejë kuotën e Shitësit të barabartë me 50% të kapitalit të Shoqërisë të Shoqërisë.

Për këto arsye, Palët, me vullnetin e tyre të plotë, të lirë e të pacënuar, vendosin të lidhin këtë Kontratë Shitblerje Kuote (në vijim referuar si "Kontrata"), me kushtet si më poshtë vijon:

NENI 1

Objekti

- 1.1. Objekti i kësaj Kontrate është përcaktimi i kushteve, modaliteteve dhe pasojave të transaksionit mbi shitjen e 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë nga Shitësi tek Blerësi sipas çmimit të përcaktuar në të.

NENI 2

Çmimi dhe mënyra e pagesës

- 2.1. Palët kanë vendosur që shitja e 50% të kapitalit të Shoqërisë nga Shitësi tek Blerësi të jetë me çmimin prej 200.000 Euro (dyqind mijë Euro). Ky çmim do të paguhet nga Blerësi brenda datës 31 mars 2024.
- 2.2. Çmimi do të paguhet nga Blerësi në favor të Shitësit nëpërmjet transfertës bankare në llogarinë bankare të këtij të fundit, të përcaktuara në dokumentacionin bashkëlidhur kësaj Kontrate, në përputhje me afatin e përcaktuar në paragrafin 2.1 më sipër. Mospagimi i çmimit në përputhje me këtë afat nga ana e Blerësit, përbën shkak për zgjidhjen e kësaj kontrate me efekt rikthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, me përjashtim të rastit kur ato zgjasin këtë afat nëpërmjet një marrëveshje të realizuar me shkrim.

NENI 3


Kalimi i titullit të pronësisë

- 3.1. Titulli i pronësisë së 50% të kapitalit të Shoqërisë nga Shitësi tek Blerësi kalon në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate Shitblerje Kuote.
- 3.2. Regjistrimi i Kontratës pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit do të ketë funksion deklarativ ndaj të tretëve dhe Blerësi fiton pronësinë mbi 50% të kapitalit të Shoqërisë që në momentin e përcaktuar nga neni 3.1 më sipër.

NENI 4

Pasojat e shitjes së kuotës

- 4.1. Palët bien dakord se pas nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe kalimit të titullit të pronësisë nga Shitësi tek Blerësi, Shoqëria do të ketë këtë strukturë ortakësh:



- I. Z. Ullis Gjata do të jetë pronar i një (1) kuote të barabartë me 50% të kapitalit të Shoqërisë.
- II. Z. Arben Goga, zotërues i (1) një kuote të barabartë me 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit të shoqërisë
- 4.2. Pjesëmarrja e palëve në të drejtat e detyrimit e shoqërisë në raport me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin e saj do të jetë efektive nga momenti i kalimit të titullit të pronësisë sipas nenit 3 të kësaj kontrate e në vijim. Çdo e drejtë apo detyrim i Shitësit në lidhje me shoqërinë i cili daton përpara datës së nënshkrimit të kësaj kontrate, do të mbetet ekskluzivisht i tij.

NENI 5 Garancitë e Palëve

5.1. Shitësi garanton Blerësin se:

- 5.1.1. Pjesët e kapitalit që ai zotëron në shoqëri dhe që janë objekt i shitblerjes sipas kësaj kontrate nuk janë subjekt sekuestrimi, ndalimi shitje, të drejte parablerje, garancie bankare, apo e ndonjë mjeti tjetër i cili siguron ekzekutimin e detyrimeve;
- 5.1.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur shitjen e pjesëve që ai zotëron në kapital dhe që janë objekt i kësaj kontrate dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik;
- 5.1.3. Ka ndërmarrë apo do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për autorizimin, ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate, përfshirë këtu miratimin e shitblerjes së pjesës së tij të kapitalit të shoqërisë nga ortaku tjetër dhe nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve sipas vendimmarrjes që i bashkëlidhet kësaj kontrate;
- 5.1.4. Përbushja e kësaj kontrate nuk do të rezultojë në situatë kundërligjshmërie, paligjshmërie apo pavlefshmërie, lidhur me Kontratën në vetvete, Statutin e Shoqërisë, marrëdhënie detyrimesh mes Shoqërisë dhe të tretëve apo Shitësit dhe të tretëve, ose me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë;
- 5.1.5. Asnjë person i tretë fizik ose juridik nuk ka të drejta mbi pjesën objekt shitblerje nga kapitali i Shoqërisë;
- 5.1.6. Shoqëria nuk ka detyrime tatimore apo fiskale të prapambetura;
- 5.1.7. As shoqëria dhe as vetë Shitësi nuk janë pjesë e ndonjë procesi gjyqësor apo procedimi administrativ, i cili mund të rezultojë në hetimin e Shoqërisë ose në ngarkimin e detyrimeve mbi kuotat, kapitalin ose asetet e shoqërisë;

5.2. Blerësi garanton Shitësin se:

- 5.2.1. Blerja e 50% të kapitalit të Shoqërisë është në përputhje me vullnetin e tij.



5.2.2. Ka të drejtë, aftësi dhe zotësi të plotë për të vendosur blerjen e 50% të kapitalit të Shoqërisë objekt i kësaj kontrate dhe për të ekzekutuar këtë Kontratë sipas parashikimeve të saj, pa patur nevojën për pëlqimin apo miratimin paraprak të ndonjë personi tjetër, qoftë ky fizik apo juridik;

5.2.3. Asnjë person i tretë fizik ose juridik nuk ka të drejta mbi kuotën apo kapitalin e Blerësit;

NENI 6

Pagesat lidhur me ekzekutimin e kësaj Kontrate

- 6.1. Të gjitha pagesat lidhur me ekzekutimin dhe regjistrimin e kësaj Kontrate do të mbarten nga Shitësi, me përjashtim të komisioneve dhe tarifave për transfertën bankare të çmimit të kuotës që mbarten nga Blerësi.

NENI 7


Dëmshpërblimi

- 7.1 Shitësi do t'i shpërblejë Blerësit dëmin e shkaktuar, si dhe do ta përjashtojë atë dhe Shoqërinë nga përgjegjësia civile apo penale lidhur me çdo pretendim, dëm, humbje, apo shpenzim, të ngritur ndaj Shoqërisë lidhur me veprime të kryera përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, apo që rezultojnë si pasojë e:
- 7.1.1. Çdo barre apo mase sigurimi mbi kotat apo kapitalin e Shoqërisë, apo çdo detyrim të Shitësit të cilin ai e ka ceduar tek Shoqëria përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate, i cili nuk është ekzekutuar;
 - 7.1.2. Çdo shkelje të garancive të Shitësit, parashikuar në nenin 5.1 të kësaj Kontrate;
 - 7.1.3. Çdo shkelje të detyrimeve të Shitësit sipas kësaj Kontrate;
 - 7.1.4. Çdo falsifikim, apo deklaram i pavërtetë i situatës ligjore dhe financiare të Shoqërisë;
 - 7.1.5. Çdo padi apo kërkesë ndaj Shoqërisë që vjen si rezultat i veprimeve të Shitësit përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 7.2. Blerësi do t'i shpërblejë Shitësit dëmin e shkaktuar dhe do të përjashtojë atë nga përgjegjësia civile për shpërblimin e dëmeve të ardhura si pasojë e:
- 7.2.1. Çdo shkelje të garancive të Blerësit, parashikuar në nenin 5.2 të kësaj Kontrate;
 - 7.2.2. Çdo shkelje të detyrimeve të Blerësit sipas kësaj Kontrate.

NENI 8

Konfidencialiteti

- 8.1. Palët bien dakord që kjo Kontratë dhe çdo negociim parakontraktor do të trajtohet në përputhje me parimin e konfidencialitetit dhe se nuk do të transmetojë asnjë të dhënë apo informacion lidhur me marrëdhëniet tregtare, financiare apo ligjore të njëra-tjetrës, si dhe se nuk do të bëjnë asnjë deklaratë lidhur me ekzistencën, objektin apo parashikimet e kësaj Kontrate.



NENI 9

Forca madhore

- 9.1. Për qëllim të kësaj kontrate, "Forcë Madhore" nënkupton një ngjarje që nuk shkaktohet dhe është përtej kontrollit të arsyeshëm të një prej palëve të kësaj Kontrate, e cila shkakton që përmbushja të detyrimeve të palës në këtë kontratë të bëhet ose e pamundur, ose aq jopraktike sa, në mënyrë të arsyeshme, të konsiderohet e pamundur duke pasur parasysh rrethanat. Ajo përfshin ndër të tjera, epidemitë, pandemitë, gjendjet e fatkeqësisë natyrore, luftën, mosbindjen civile, stuhitë, përmbytjet ose grevat.
- 9.2. Në rastet e ekzistencës së kushteve të Forcës Madhore, afatet e parashikuara në të këtë kontratë për ekzekutimin e detyrimeve mund të shtyhen nëse është e nevojshme për aq kohë sa zgjat Forca Madhore. Forca Madhore nuk përfshin pamjaftueshmërinë e fondeve ose moskryerjen e një pagese që duhet kryer sipas kontratës.

NENI 10

Komunikimi ndërmjet palëve

- 10.1. Të gjitha komunikimet ndërmjet palëve, si dhe kërkesat që ato kanë ndaj njëra tjetrës, do të kryhen në mënyrë shkresore ose nëpërmjet e-mail-it, në adresat dhe e-maillet e përcaktuara nga palët në pjesën e gjeneraliteteve të tyre.
- 10.2. Në rast se personat dhe/ose adresat dhe/ose e-mail-et e mësipërme pësojnë ndryshime, Pala që i pëson ato ka detyrimin të njoftojë palën tjetër brenda 24 orësh nga momenti i ndryshimit. Në rast të kundërt, çdo komunikim në adresën e mëparshme do të konsiderohet i vlefshëm edhe pse mund të mos jetë marrë nga ana e Palës që ka ndryshuar personin e kontaktit dhe/ose adresën dhe/ose e-mail-in.
- 10.3. Çdo komunikim ndërmjet palëve është konfidencial dhe nuk mund t'i transmetohet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë personave të tretë me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 8.2 i kësaj Kontrate.

NENI 11


Ndryshimet e kontratës

- 11.1. Çdo ndryshim i kësaj Kontrate bëhet me pëlqimin e përbashkët të palëve dhe do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se bëhet me shkrim dhe në nënshkruhet nga të gjitha palët në këtë Kontratë.

NENI 12

Interpretimi i kontratës

- 12.1. Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e aktit. Në rast dyshimi, kontrata ose kushtet e saj interpretohen në kuptimin në të cilin mund të kenë ndonjë efekt dhe jo në atë, sipas të cilit nuk do të kishte ndonjë efekt.



- 12.2. Ligji i zbatueshëm për interpretimin e kësaj Kontrate do të jetë legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 13

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 13.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet Palëve lidhur me këtë Kontratë, palët duhet të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim.
- 13.2. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, Kontrata do të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor dhe kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 14

Të tjera

- 14.1. Bashkëlidhur dhe pjesë integrale e kësaj Kontrate janë:
- 14.1.1. Kopje e letërnjoftimit të palëve nënshkruese;
 - 14.1.2. Ekstrakt nga regjistri tregtar i Shoqërisë 3Ad Energy shpk;
 - 14.1.3. Të dhënat e llogarive bankare në të cilën do të kryhet arkëtimi i çmimit të shitjes së Kuotës;
 - 14.1.4. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shitësit për miratimin e lidhjes së kësaj Kontrate.
- 14.2. Kjo kontratë është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën palë nënshkruese.
- 14.3. Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

SHITËSI:

Z.Nikos Semanjakos

Nikos Semanjakos
(emër, mbiemër, nënshkrim)

BLERËSI:

Z. Ulis Gjata

ULIS GJATA
(emër, mbiemër, nënshkrim, vulë)

DHËNËSE PËLQIMI

Znj.Sonila Semanjakos

Sonila Semanjakos
(emër, mbiemër, nënshkrim)